**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

**01 Nr. 02/22**
**Rahovec, 16.02.2022**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **28 shkurt 2022 (e hënë ),** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec:
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP);
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01472-3 në Zonën Kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-71510057-01997-10 dhe P-71510057-01997-11, zona kadastrale Rahovec;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për subvencionimin e lindjeve për gratë–nënat banore të komunës së Rahovecit për vitin 2022;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale;
14. Shqyrtimi i Raporti nga Komiteti për Komunitete për vitin 2021;
15. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Defrim Kafexhiu**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.9, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

## VENDIM
**Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/1528/22 i datës 07.02.2022 dhe merret vendimi me të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shërbimeve të varrimit).
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë kosto më të lartë se **200.00 € (dyqind euro)** për një rast, ndërsa për shërbimet tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahen të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime.**
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën së Rahovecit.
8. Pas miratimit nga Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr._____/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1528 Nr. i faq/Br.str/No.pg 317
Data/Datum/Date 7/2/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit me të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2022, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shpenzimeve të varrimit).

2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë koston më të lartë se **200.00 € (dyqind euro)** për një rast, ndërsa për shërbime të tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.

3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.

4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.

5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahet të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.

6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime.**

7. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

8. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me propozim të njoftohen:***
1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
3. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

| NR.REND | LLOJI I SHËRBIMIT | SHUMA |
|---|---|---|
| 1 | TRANSPORTI I KUFOMËS BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT (bartja e kufomës nga shtëpia deri në xhami (vendfalje) dhe përcjellja në varreza. | 30 |
| 2 | HAPJA DHE MBYLLJA E VARRIT (sipas parimeve fetare islame). Transporti i punëtorëve dhe mjeteve te punës në varreza. | 45 |
| 3 | DËRRASAT- (pa arkivol)- dërrasat me të cilat mbulohet i vdekuri pas lëshimit në varr me dimens. 2.10 x 1.10 x 0.4) . Transporti i dërrasave deri te vendi i varrimit. | 50 |
| 4 | QEFINI - mbështjellës i veçantë për kufomën sipas parimeve islame dhe mjetet higjienike, (përfshihen dorëzat higjienike si dhe pambuku, shamponi dhe sapuni). | 25 |
| 5 | PIRAMIDA (dërrasë me mbishkrimin e të dhënave të të vdekurit) | 20 |
| 6 | KUJDESTARIA 24 orë duke përfshirë edhe ditët e vikendeve. Regjistrimi i të dhënave të personit të vdekur në librin amëz i të vdekurve. | 15 |
| 7 | DEZINFEKTIMI I VETURËS | 5 |
| 8 | AFISHET (FLETËLAJMRIMET) 20 COPA | 10 |
|  | TOTALI | 200 € |

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 65 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

# VENDIM
## Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022

1. **Miratohet** vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën prej **592,276.56€ (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent).**

2. Mjetet në shumën prej **592,276.56€ (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent)** do të barten në vitin 2022 në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:

- **Në kategorinë e investimeve kapitale:**

**2.1 Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

a) Ndërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, Brestoc, Krushë e Madhe dhe Fortesë, kodi **40817** në shumën prej **33,988.20€;**
b) Ndërtimi i rrugëve në Drenoc, Çifllak, Dejnë, Malësi e Vogël dhe Opterushë, kodi **40817** në shumën prej **3,030.85€;**
c) Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit, kodi **49862** në shumën prej **40,000.00€;**
d) Intervenimet emergjente në infrastrukturë në Komunën e Rahovecit - LotII, kodi **40815** në shumën prej **20,000.00€;**
e) Furnizim me Gypa PVC, kodi **48189** në shumën prej **20,000.00€;**

**2.2 Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

a) Ndërtimi i kompleksit përkujtimor të dëshmorëve të kombit, kodi **40848** në shumën prej **3,499.29€;**
b) Ndërtimi i shtëpisë së përbashkët për banim – faza përfundimtare, kodi **40844** në shumën prej **50,000.00€;**
c) Hartimi i projekteve të ndryshme, kodi **40839** në shumën prej **80,000.00€.**

**2.3 Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Administrata (92055), kodi funksional (0980).**

a) Ndërtimi i SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc, kodi **46517** në shumën prej **16,589.63€;**

b) Ndërtimi i çerdhes në Xërxë, kodi **48206** në shumën prej **16,183.72€;**
c) Ndërtimi i SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec në shumën **prej 60,000,00€;**
d) Ndërtimi i SHFMU "Hamëz Thaqi" në Xërxë në shumën **prej 60,000,00€;**
e) Ndërtimi i aneksit të SHFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc në shumën **prej 60,000,00€.**

**2.4 Në programin Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470), nën programin Bujqësia (47011), kodi funksional (0421).**
a) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, kodi **40822** në shumën prej **50,000.00€;**
b) Ndërtimi i qendrës për magazinimin e prodhimeve bujqësore – (projekt i ri) në shumën prej **20,717.87€.**

**2.5 Në programin Zhvillimi Ekonomik (480), nën programin Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411).**
a) Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar, kodi **48051** në shumën prej **8,267.00€.**

**2.6 Në programin Kulturë, Rini dhe Sport (850), nën programin Shërbimet Kulturore - Rahovec (85011), kodi funksional (0820).**
a) Ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe (Ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sylejman Krasniqi), kodi **50753** në shumën prej **50,000.00€.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr.____/22**
**Datë: 28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1535 Nr. i faq/Br.str/No.pg 318
Data/Datum/Date 8/1/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**P R O P O Z O N**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin lejohet bartja e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022.

2. Mjetet e pa shpenzuara nga viti 2021 janë në shumë prej **592,276.56€ (pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent),** këto mjete do të barten në vitin 2022 dhe do të shpërndahen në kategori ekonomike të caktuara, si në vijim:

- **Në kategorinë e investimeve kapitale:**

**2.1.Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

a) Ndërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, Brestoc, Krushë e Madhe dhe Fortesë, kodi **40817** në shumën prej **33,988.20€;**
b) Ndërtimi i rrugëve në Drenoc, Çifllak, Dejnë, Malësi e Vogël dhe Opterushë, kodi **40817** në shumën prej **3,030.85€;**
c) Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit, kodi **49862** në shumën prej **40,000.00€;**
d) Intervenimet emergjente në infrastrukturë në Komunën e Rahovecit - LotII, kodi **40815** në shumën prej **20,000.00€;**
e) Furnizim me Gypa PVC, kodi **48189** në shumën prej **20,000.00€;**

**2.2.Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

a) Ndërtimi i kompleksit përkujtimor të dëshmorëve të kombit, kodi **40848** në shumën prej **3,499.29€;**
b) Ndërtimi i shtëpisë së përbashkët për banim – faza përfundimtare, kodi **40844** në shumën prej **50,000.00€;**
c) Hartimi i projekteve të ndryshme, kodi **40839** në shumën prej **80,000.00€.**

**2.3.Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Administrata (92055), kodi funksional (0980).**

a) Ndërtimi i SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc, kodi **46517** në shumën prej **16,589.63€;**

b) Ndërtimi i çerdhes në Xërxë, kodi **48206** në shumën prej **16,183.72€;**
c) Ndërtimi i SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec në shumën **prej 60,000,00€;**
d) Ndërtimi i SHFMU "Hamëz Thaqi" në Xërxë në shumën **prej 60,000,00€;**
e) Ndërtimi i aneksit të SHFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc në shumën **prej 60,000,00€.**

**2.4.Në programin Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470), nën programin Bujqësia (47011), kodi funksional (0421).**
a) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, kodi **40822** në shumën prej **50,000.00€;**
b) Ndërtimi i qendrës për magazinimin e prodhimeve bujqësore – (projekt i ri) në shumën prej **20,717.87€.**

**2.5.Në programin Zhvillimi Ekonomik (480), nën programin Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411).**
a) Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar, kodi **48051** në shumën prej **8,267.00€.**

**2.6.Në programin Kulturë, Rini dhe Sport (850), nën programin Shërbimet Kulturore - Rahovec (85011), kodi funksional (0820).**
a) Ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe (Ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atdhetarin Sylejman Krasniqi), kodi **50753** në shumën prej **50,000.00€.**

3. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***
- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC / ORAHOVAC

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | 08.02.2022 |
| Për/Za/To: | **z.Defrim Kafexhiu: Kryesues i Kuvendit të Kuvendit Komunal Rahovec** |
| Nga/Od/From: | **z. Afrim Limani: Zyrtar Kryesor Financiar** |
| Subjekti/Predmet/Subject: | **Propozim për bartjen e mjeteve vetanake** |

**Të nderuar,**

Me anë të kësaj shkresë po ju dërgojmë bartjen e mjeteve nga viti 2021 në vitin 2022 në shumën prej **592,276.56 €**.

**Shpërndarja e të hyrave vetanake janë në kategori ekonomike:**

**-Në kategorinë e Investimeve Kapitale**

**1. Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**

1. Ndërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, Brestoc, Krushë të Madhe dhe Fortesë, kodi **40817** në shumë prej **33,988.20 €;**

2. Ndërtimi i rrugëve në Drenoc, Qifllak, Dejnë, Malësi e Vogël dhe Opterushë, kodi **40817** në shumë prej **3,030.85 €;**

3. Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit, kodi **49862** në shumë prej **40,000.00 €;**

4. Intervenimet emergjente në infrastrukturë në Komunën e Rahovecit - lot II, kodi **40815** në shumë prej **20,000.00 €;**

5.Furnizim me gypa PVC, kodi **48189** në shumën prej **20,000.00**

**2. Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

1. Ndërtimi i kompleksit përkujtimor të dëshmorëve të kombit, kodi **40848** në shumë prej **3,499.29 €;**

2. Ndertimi i shtepisë së përbashkët për banim-faza përfundimtare, kodi **40844** në shumë prej **50,000.00 €.**

3.Hartimi i projekteve të ndryshme ,kodi **40839** në shumë prej **80,000.00 €.**

**4. Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Administrata (92055), kodi funksional (0980).**

1. Ndërtimi i SHFMU "Heronjët e Kosovës" në Hoqë e Vogël - Brestoc, kodi **46517** në shumën prej **16,589.63 €;**

2. Ndërtimi i çerdhes në Xërxë, kodi **48206** në shumën prej **16,183.72 €;**

3. Ndërtimi i SHFMU "Bekim Sylka" Rahovec në shumën prej **60,000.00 €;**

4. Ndërtimi i SHFMU "Hamëz Thaqi" Xërxe në shumën prej **60,000.00 €;**

5. Ndërtimi i aneksit te SHFMU "Katër Dëshmorët" në Ratkoc në shumën prej **60,000.00 €.**

**5. Në programin Bujqesia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470) , nën programin Bujqesia (47011), kodi funksional (0421).**

1.Ndërtimi dhe mirmbajtja e rrugëve fushore,kodi **40822** në shumën prej **50,000.00 €;**

2.**Ndërtimi i qendrës për magazinimin e prodhimeve Bujqësore –(projekt i ri)** në shumën prej **20,717.87 €;**

**6. Në programin Zhvillim Ekonomik (480), nën programin Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411).**

1. Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar, kodi **48051** në shumën prej **8,267.00 €;**

**7. Në programin Kulturë,Rini dhe Sport (850), nën Shërbimet Kulturore – Rahovec (85011), kodi funksional (0820).**

1. Ndërtimi i muzeut në Krushë të Madhe (Ndërtimi i muzeut për shkrimtarin dhe atëdhetarin Sylejman Krasniqi), kodi **50753** në shumën prej **50,000.00 €;**

**Ju faleminderit**

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Udhëzimi Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/042 të dt. 02.02.2022, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP)**

1. **Caktohet** komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP) në komunën e Rahovecit që kanë konkururar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:

   **1.1.** Lulzim Krasniqi, Udhëheqës i Sektorit për Arsim, kryesues
   **1.2.** Beatrisa Pista - Demiri, Drejtoreshë e SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec, anëtare
   **1.3.**Anëtari i tretë vjen nga MASH-i sipas UA Nr. 151/2020 i dt. 22.12.2020

2. Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkuruar në konkurset e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërim të kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendësdrejtor/eshë e shkollës sipas konkursit.
3. Obligohet komisioni përzgjedhës që punët t'i kryej duke u bazuar në liget dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vit.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 175/21 i datës 26.02.2021
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr.___/22**
**Datë:00.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

______________

**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

**V E N D I M**
**Për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec**

1. Me këtë vendim **formohet** komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec, në këtë përbërje:

   **1.1.** ____________, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar;
   **1.2.** ____________, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar;
   **1.3.** ____________, i emëruar nga Kryetari i Komunës, anëtar;

2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi janë të përcaktuar me Ligjin Nr-03/L-087 për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 31/2008" dhe dispozitave të Ligjit Nr-04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 39/2008" dhe ligjet tjera që janë në fuqi të aplikueshme.

3. Për punën që do ta kryej komisioni do të kompensohen nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë dhe pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale "KRM Ekoregjioni" në Rahovec.

4. Anëtaret e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

5. Mandati i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec.

6. Kuvendi i Komunës në Rahovec e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *NPL "KRM Ekoregjioni" në Rahovec,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr.____/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

# VENDIM
## Për formimin e komisionit komunal të aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec

1. Me këtë vendim **formohet** komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Rahovecit për Ndërmarrjen Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve në Rahovec", në këtë përbërje:

   **1.1.** ____________, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar;
   **1.2.** ____________, i emëruar nga Kuvendi i Komunës, anëtar;
   **1.3.** ____________, i emëruar nga Kryetari i Komunës, anëtar;

2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit sipas pikës 1 të këtij vendimi janë të përcaktuar me Ligjin Nr-03/L-087 për Ndërmarrjet Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 31/2008" dhe dispozitave të Ligjit Nr-04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 39/2008" dhe ligjet tjera që janë në fuqi të aplikueshme.

3. Për punën që do ta kryej komisioni do të kompensohen nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë dhe pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec.

4. Anëtaret e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda vitit kalendarik.

5. Mandati i anëtareve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Rahovec.

6. Kuvendi i Komunës në Rahovec e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***NPL "Stacioni i Autobusëve" në Rahovec,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr.___/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**_________________**
**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17, nenit 34 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 7 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 13, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

**VENDIM**
**Për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale**

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për shqyrtimin e ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale në fshtara, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Rahovecit.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 3 (tre) anëtarëve të cilat zgjedhën nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, si në vijim:

   **2.1.** ____________, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik AAK;
   **2.2.** ____________, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik LVV;
   **2.3.** ____________, anëtar Kuvendi i Komunës nga subjekti politik LDK;

3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.

4. Komisioni i ankesave ka për detyë që të bëjë shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga palët në procesin zgjedhor për zgjedhjen e këshillave lokal dhe atë brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të ankesës, t`u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesën.

5. Komisioni i ankesave ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim që e mbanë dhe t'i raportojë Kuvendit të Komunës.

6. Obligohet komisioni që punët t'i kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21, të datës: 29.03.2021.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr.____/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**_____________________**
**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17, nenit 34 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 3 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 13, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

## VENDIM

**Për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale**

1. Me këtë vendim emërohet komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshtara, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Rahovecit.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve, ku 4 (katër) anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës, 1 (një) anëtar është nga ekzekutivi i komunës, 1 (një) anëtar nga shoqëria civile dhe 1 (një) anëtar përfaqësues fshati, vendbanimi apo lagjja urbane, si në vijim:

   **2.1.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.2.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.3.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.4.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.5.** ____________, anëtar nga ekzekutivi i Komunës;
   **2.6.** ____________, anëtar nga shoqëria civile;
   **2.7.** Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane.

3. Kryesuesi i komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.

4. Komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në Komunën e Rahovecit.

5. Komisioni ka për detyrë që në bashkëpunim dhe përmes Zyrës për Informim, të informoj qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale përmes: shpalljeve publike të vendosuara në objektet publike dhe hapësirat e frenkuentura; mediave lokale; ueb-faqes zyrtare të Komunës dhe platformave tjera të komunikimit.

6. Komisioni ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim me qytetarë dhe i njëjti duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin dhe listën e pjesëmarrësve dhe i njëjti të nënshkruhet nga kryesuesi i takimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi konform

nenit 5 paragrafi 9 dhe 10 i Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës: 29.03.2021.

7. Obligohet komisioni që punët t'i kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane si dhe Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Rahovecit 01 Nr. 178/21 të datës 29.03.2021.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr. ___/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-092 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës ës Paluajtshme të Komunës, nenit 28 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2022 miraton këtë:

## V E N D I M

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/1534/22 i datës 08.02.2022 për për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Vr.nr. 1338.2000 e datës 30.10.2000, me qëllim të vazhdimit të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për një periudhë tjetër të caktuar kohore.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 3 (tre) anëtarë propozohen nga Kuvendi i Komunës dhe 2 (dy) anëtar propozohen nga Kryetari i Komunës, si në vijim:

   **2.1.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.2.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.3.** ____________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   **2.4.** ____________, anëtar nga ________________;
   **2.5.** ____________, anëtar nga ________________.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të bëjë performancën e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Vr.nr. 1338.2000 e datës 30.10.2000; të bëjë vlerësimin e përmbushjes së kontratës, të bëjë vlerësimin dhe të përshkruaj gjendjen aktuale të pronës së dhënë në shfrytëzim sipas kontratës; të bëjë vlerësimin e qarkullimit financiar për periudhën shfrytëzuese të pronës si dhe çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me shfrytëzuesin e deritanishëm të pronës së paluajtshme komunale.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës ës Paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas miratimit të propozimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 7 Mars.

6. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01 Nr.____/22**
**Datë:28.02.2022**

**Defrim Kafexhiu**

____________________

**Kryesues i Kuvendit**

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1534 Nr. i faq/Br.str/No.pg 318
Data/Datum/Date 8 ... 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-092 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës ës Paluajtshme të Komunës, nenit 28 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit për formimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Vr.nr. 1338.2000 e datës 30.10.2000 me qëllim të vazhdimit të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës për një periudhë tjetër të caktuar kohore.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 3 (tre) anëtarë propozohen nga Kuvendi i Komunës dhe 2 (dy) anëtarë propozohen nga Kryetari i Komunës, si në vijim:
   - **2.1** ______________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   - **2.2** ______________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   - **2.3** ______________, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
   - **2.4** ______________, anëtar nga ________________;
   - **2.5** ______________, anëtar nga ________________.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të bëj performancën e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Vr.nr. 1338.2000, e datës: 30.10.2000; të bëj vlerësimin e përmbushjes së kontratës, të bëj vlerësimin dhe të përshkruaj gjendjen aktuale të pronës së dhënë në shfrytëzim sipas kontratës; të bëj vlerësimin e qarkullimit financiar për periudhën shfrytëzuese të pronës si dhe çështje tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me shfrytëzuesin e deritanishëm të pronës së paluajtshme komunale.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-092 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës ës Paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
5. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas miratimit të propozimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 7 mars.
6. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
7. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me propozim të njoftohen:***

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
3. ***Arkivi.***

**Smail Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPALITY MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

KUVENDI KOMUNAL
Rr. "Xhelal Hajda – Toni"
Rahovec

SKUPŠTINA OPŠTINE
Ul. "Xhelal Hajda – Toni"
Orahovac

Municipal Assambli
Str. "Xhelal Hajda-Toni
Rahovec

Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro – juridik
Odeljenje za katastar, geodeziju i imovinsko-pravna sluzba

---

08 nr. 155/07

**Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro-juridik e KK Rahovecit,** duke vendosur sipas kërkesës së Schuler Helfen Leben – Qendrës Rinore me seli në Rahovec, 08 nr. 1310 të dt. 26.06.2007, në çështjen administrative – Bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës në pronësinë shoqërore, në bazë të nenit 70 të Ligjit mbi ekspropriim ("Gazeta zyrtare e Kosovës", nr. 21/78), nenit 29 dhe 30 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ekspropriim ("Gazeta zyrtre e Kosovës," nr. 46/86) të cilat ligje sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 58/2000) konsiderohen si ligjet të aplikueshme në Kosovë, dhe nenit 13 të Ligjit mbi procedurën administrative nr. 02/L-28 ("Regullore nr. 2006/33, merr

**A K T V E N D I M**

**I.- APROVOHET** kërkesa e Schuler Helfen Leben – Qendra Rinore me seli në Rahovec dhe **BARTET e drejta e shfrytëzimit** të paluajtshmërisë, nga PSH e Kosovës, titullar KK Rahovec, shfrytëzues BVI për kulturë dhe edukim Rahovec, në emër të Schuler Helfen Leben – Qendrës Rinore Rahovec, si shfrytëzuese e ardhëshme e parcelës kadatrale nr.1862/20, në vend të qyajtur "Qytet", sipas kulturës ndërtesë në sipërfaqe prej 0.03,13 ha dhe oborr në sipërfaqe prej 0.06,87 ha, nga fleta e posaedimit nr. 1821 z.k. Rahovec.

**A r s y e t i m**

Schuler Helten Leben – Qendra Rinore me seli në Rahovec, me kërkesën 08 nr. 1310 të dt. 26.06.2007 është drejtuar kësaj drejtorie, me të cilën ka kërkuar marrjen e Vendimit mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të parcelës në pronësinë shoqërore më afër të cekur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Propozusi këkesës i ka bashkangjitur Aktvendimin e plotëfuqishëm e KK Rahovecdit, 01 nr. 264 të dt. 14.02. 2001 mbi ndarjen e tokës shoqërore në shfrytëzim pa kompensim, Fletën e posedimit për parcelën kadastrale nr. 1862/20, mbi bartjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe aktvendimin e KK Rahovecit 01 nr. 3284 të dt. 01. 11. 2000 mbi vërtetimin e interesit të përgjithshëm shoqëror, për ndërtimin e objektit të Qendrës Rinore në këtë lokacion.

Pas kryerjes së punëve teknike nga ana e ekspertit të gjeodezisë Miftar Krasniqi, i cili ka kryer matjen dhe inçizimin e parcelës në fjalë bashkë me objektin ndërtimor dhe ka hartuar

skicën e terrenit dhe kopjen e planit, në të cilën është pasqyruar pozita, kufiri dhe sipërfaqja e parcelës së kërkuar, janë vërtetuar faktet dhe rrethanat të cilat janë eminente për marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm, dhe se kërkesa e Schulen Helfen Leben – Qendrës Rinore me seli në Rahovec, është e arsyeshme, pasi që në bazë të dispozitave të nenit 29. dhe 30 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi ekspropriim, mund të jetë bartëse e të drejtës së shfrytëzimit të tokës në pronësinë shoqpërore, në të cilën të drejtën e shfrytëzimit ka BVI për arsim dhe edukim Rahovec.

Në bazë të vërtetimit të kësaj gjendje faktike, me aplikimin e dispozitave të nenit 29 dhe 30 të ligjit në fjalë,është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

**Eshtë vendosur pranë Drejtorisë për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro-juridik e KK Rahovecit, më 27. 06. 2007**

**08 nr. 155/06**

Kundër këtij aktvendimi në bazë të nenit 35 al. 1. të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 200045 mund të parashtrohet ankesë Kryeshefit ekzekutiv të KK Rahovecit., në afat prej 15 ditësh,nga dia e pranimit. Nësa pala nuk do të jetë e'kënaqur me përgjegje në ankesë, menjëherë mund të parashtrojë ankesë e veçant Agjencionit kadastral të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj drejtorie.

**Menaxheri i shërbimit**
**Kapllan Gashi, jur. i dipl.,**

**D r e j t o r i**
**Ali Hoxha**

VEREJTJE: Meqenëse përfaqësuesi i autorizuar avokati publik komunal dhe pala e interesuar pranë kësaj drejtorie kanë deklaruar se nuk do të ankohen kundër këtij aktvendimi, për shkak të auditimit të cilën duhet të prezentojë pala pranë Ministrisë për shërbime publike në Prishtinë, i njëjti është bërë i plotëfuqishëm më 28.06.2007.

D r e j t o r i,
Ali Hoxha

Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe shërbimi pronësoro-juridik
Odeljenje za katastar, geodeziju i imovinsko-pravnu službu
Rahovec - Orahovac

# Kopja e planit - Kopija plana

Zona kad. / Kat. zona: Rahovec

Shk. e zvog. 1 : 500
Razmer 1 :

Poseduesi / Vlasnik: SCHÜLER HELFEN LEBEN
QENDRA RINORE RAHOVEC 1/1




os. Nr. / Br. 1389 / dt. / dt. 9.07.2007

| Numri i parcelës / Broj parcele | Potezi - vendi i quajtur / Potez - zvano mesto | Kultura | Klasa | Sipërfaqja / Površina ha | ar | m² | Të ardh.kadast. / Katarski prihod |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Qytet | Ndërtesë | – | – | 03 | 13 | |
| 1862 | Qytet | Oborr | – | – | 06. | 82 | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | Gjithsejtë: | | | – | 10 | 00 | |

Qe kjo kopje i është besnike origjinalit të vet sipas gjendjes së fundit në kadastër
Ova kopija je identična svom originalu prema poslednjem stanju u katastar.

Kopjoi: - Kopirao:

[signature]

